



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN  
REKTORATI

Nr. 1138 prot.

Elbasan, më 12.09.2017

UDHËZIM

Nr. 5, datë 12.09.2017

PËR

**PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE FITUES NË  
PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT NË UNIVERSITETIN E  
ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI", PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018**

Në mbështetje të nenit 25 pika 7, 8 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV/2 të Udhëzimit të MAS Nr.15, datë 19.05.2017, të ndryshuar me Udhëzim Nr. 18, datë 16.08.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018, Vendimin e Senatit Akademik nr. 1, datë 11.01.2017 "Për miratimin e kriterëve shtesë për pranimin në programet e studimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"; Vendimin e Bordit të Administrimit, nr.12, datë 10.07.2017 "Për vendosjen e tarifave, tarifë konkurrimi, tarifë regjistrimi, tarifë shkollimi në "Bachelor" dhe "MSH e "MP" për vitin akademik 2017-2018";

**U D H Ë Z O J:**

1. Në datat **15 Shtator 2017 deri më 20 Tetor 2017**, në sekretaritë mësimore të fakulteteve të kryhet regjistrimi me dokumentacion i kandidatëve që kërkojnë të aplikojnë në programet e studimit të ciklit të dytë nga ora 8<sup>00</sup>-16<sup>00</sup>.
2. Brenda datës 24 tetor 2017, të shpallen listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njëjësive kryesore përkatëse, në faqen e web të UE të ndarë sipas programeve të studimit të renditur sipas rendit zbritës.
3. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet nga data 27 tetor 2017 deri në datën 30 tetor 2017 pranë sekretarive mësimore përkatëse.
4. Lista emërore e kandidaëve fitues të regjistruar sipas pikës 3 të këtij udhëzimi publikohet në hardcopy dhe elektronikisht brenda datës 1 nëntor 2017.
5. Kandidatët do të dorëzojnë personalisht, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Diplomë, ose fotokopje të saj të njëzuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njëzuar me origjinalin,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN**  
**REKTORATI**

---

ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve në vendin përkatës.

- Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduara jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njëzuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
- Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njëzuar me origjinalin, e konfirmuar nga njesia perkatese arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Matures Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njëzuar me origjinalin, të konfirmuar nga njesia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).  
Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njesia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i shtetit së bashku me listën e notave. Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë shtetit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga MAS
- Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr 8, bashkëlidhur këtij Udhëzimi)
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Dy fotografi personale
- Mandat pagese e tarifës së regjistrimit prej 2500 lekesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN  
REKTORATI

6. Sekretaritë mësimore, të mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit për atë vit akademik.
7. Ngarkohen Zv/Rektori, Dekanët e Fakulteteve, Sekretaritë mësimore, Drejtoria e Standardeve dhe Kurrikulave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. Skender TOPI

